



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.07.2023

Nr: 703

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

DELEGIMIN E KOMPETENCËS KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR. 43, BASHKIA RROGOZHINË, PËR AKREDITIMIN E VËZHguesVE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR PËRSËRITJEN E ZGJEDHJEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË RROGOZHINË, TË DATËS 23 KORRIK 2023

Në mbështetje të nenit 6, pikat 1, 4 e 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8 të vendimit nr. 23, datë 1.2.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, Komisionet e Qendrave të Votimit dhe Vendet e Numërimit të Votave, në zgjedhje”,

V E N D O S :

1. T’i delegojë Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 43, Bashkia Rrogozhinë, kompetencën për të akredituar vëzhguesit e subjekteve zgjedhore për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar Bashkie Rrogozhinë, të datës 23 Korrik 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 14.07.2023 Nr: 703
Ora: 12:30



“Për delegimin e kompetencës Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 43, Bashkia Rrogozhinë, për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 Korrik 2023”